

RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

1. Titulli i draft aktit/dokumentit

Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021 - 2030”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Kohëzgjatja e konsultimeve për projektvendimin ka qenë 26 ditë pune. Në datë 25.10.2021 është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel ekspertit dhe qytetari) si dhe në ëbsite zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë <https://ëëë.infrastruktura.gov.al/konsultime-publike/>.

Konsultimet u zgjatën deri në datë 6.12.2021 bazuar në nenin 15 pika 2 dhe nenin 16 të Ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i cili parashikon zgjatjen edhe përsëritjen e fazës së konsultimit.

3. Metoda e konsultimit

Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është zhvilluar procesi i konsultimit publik nëpërmjet:

- Publikimit të projektvendimit më datë 25.10.2021, në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike;
- Publikimit të projektvendimit në ëbsite zyrtare të MIE;
- Tryezë konsultimesh me ekspertë në datë 6.12.2021 pranë ambjenteve të MIE,
- Ndërmjet postës elektronike:
vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al.

4. Palët e interesit të përfshira

Projektvendimi është publikuar për konsultim në nivel ekspertit dhe qytetari.

Për procedim të mëtejshëm projektvendimi është dërguar për mendim ndërmjet sistemit të e-akteve në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (bashkëfirmosje).

Ndërkohë në mënyrë shkresore i është marrë mendim paraprak përpara hartimit të projektaktit OSHEE sh.a, ERRE, KESH sh.a.

Palët e interesit pjesëmarrëse në tryezën e konsultimit ishin: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), INSTAT, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), eksperti i VSM (GIZ). Ndërkohë janë paraqitur komente dhe ofruar kontribut nga Instituti i Politikave Mjedisore dhe nga organizata “Miq të Korçës”. Dokumenti është konsultuar edhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Vjenë.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Komentet dhe Propozimet e marra:

Nga aktorët e interesuar nuk ka patur propozime për draftin.

Çështjet e adresuara	Komentet	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Përditësimi me zotimet e përditësuara të kontributit kombëtar të përcaktuar prej 20.9%	<p>“Novacioni dhe konkurrenca”:</p> <p>Rezultatet që duhet të arrijë ky PaM ë duhet të zgjerohen me: Bashkëpunimi me Universitete e ente kërkimi për zgjidhje Novatore.</p> <p>Promovimi dhe mbështetja e start-ups me teknologji pa çlirim të CO2.</p> <p>Edukimi i integruar: mungon si do të pasqyrohet psh integrimi në kurrikulat shkollore.</p>	<p>Instituti i Politikave Mjedisore</p> <p>Organizata “Miq të e Korçës”</p>	Pranuar pjesërisht	Kostot e mëdha financiare.